



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E PUSHTETIT VENDOR
DHE DECENTRALIZIMIT**

**MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCES**

DOKUMENT

PER POLITIKAT E DECENTRALIZIMIT NE SEKTORIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

I. Hyrje

Qeveria shqiptare ka hyrë në procesin e reformimit të sistemit arsimor dhe veçanërisht në arsimin parauniversitar dhe është angazhuar në decentralizimin e tij, duke e konsideruar atë si një mjet drejt përmirësimit të cilësisë. Që nga viti 2000, një numër dokumentesh strategjike kanë trajtuar çështjen e decentralizimit të të gjitha funksioneve qeverisëse në përgjithësi dhe të sistemit arsimor në veçanti. Megjithë arritjet e deritanishme, është e nevojshme të formulohet një platformë më e qartë decentralizimi, e shoqëruar nga një plan konkret veprimi.

Kjo platformë synon në:

- a) Ndarjen e përgjegjësive funksionale në sektorin e arsimit ndërmjet niveleve të qeverisjes, dhe
- b) Identifikimin e kushteve për të rritur përgjegjësinë mbi funksionet që priten të decentralizohen, nga niveli qendror në nivel vendor.

Në këtë dokument pershkrohen çështjet qendrore në lidhje me Decentralizimin, përfshirë disa përkufizime, avantazhe dhe disavantazhe, si dhe kushtet që bëjnë të mundur arritjen e suksesit.

Ky dokument është mbështetur në :

- Strategjine e Decentralizimit dhe Autonomise se Pushtetit Vendor
- Ligjin nr.8652, date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"
- Objektivat e SKZHES ne fushen e arsimit parauniversitar
- Angazhimin e Ministrise se Arsimit dhe Shkences per hartimin e ligjit te Arsimit Parauniversitar

- Bashkepunimin dhe angazhimin e perbashket te Ministrise se Arsimit dhe Shkences dhe Ministrise se Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

II. Parimet bazë dhe përkufizimet

Në vazhdim të përshkrimit të koncepteve të përgjithëshme lidhur me decentralizimin, duke patur në konsideratë edhe eksperiencën ndërkombëtare, do të evidentohet ndarja e përgjegjësive dhe kompetencave për sistemin arsimor parauniversitar midis aktorëve të interesuar.

Në këtë dokument sugjerohen edhe Projekte Pilote, për t'i paraprirë procesit të krijimit të kapaciteteve të nevojshme për të rritur mundësitë drejt suksesit.

Qëllimi i një sistemi qeverisës të decentralizuar është të sjellë procesin vendimmarrës sa më afër që të jetë e mundur me nivelin që shpërndan shërbimin.

Një proces i shëndoshë decentralizimi mbështetet në besimin se, efektshmëria e disa shërbimeve, përfshirë shërbimin arsimor, rritet proporcionalisht me rritjen e përgjegjshmërisë (accountability) së përfaqësuesve vendor. Njohja më e mirë e kushteve vendore dhe një strukturë e bazuar në zinxhirë më të shkurtër përgjegjësish mundësojnë përmirësimin e cilësisë e shërbimeve që i ofrohen komunitetit.

Proçesi i decentralizimit duke qenë një përqsaje shumë dimensionale, kërkon të mbahen parasysht:

- Kultura e menaxhimit
- Ndjeshmëritë psikologjike
- Politikat kombëtare dhe vendore
- Kuadri ligjor
- Financat
- Planifikimi strategjik
- Ngritja e kapaciteteve

Gjatë trajtimit të materialit janë mbajtur në konsideratë tipet e mëposhtme të decentralizimit:

- Dekoncentrimi, i cili shpërndan autoritetin e vendimmarrjes dhe përgjegjësisë drejtuese financiare, ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes *qendrore*. Ai thjesht mund të zhvendosë përgjegjësitë nga strukturat e qeverisjes qendrore, në strukturat e saj rajonale, duke krijuar një administrim dhe kapacitete menaxhuese nën mbikqyrjen e ministrive më afër përfituesve të shërbimit.

- Delegimi nënkupton kalimin e përgjegjësive të veçanta për vendimmarrje dhe administrim për detyra të caktuara, pa shmangur përgjegjësinë e qeverisjes qendrore.
- Transferimi (devolution) nënkupton kalimin e përgjegjësisë, autoritetit dhe përgjegjshmërisë për vendimmarrje, realizim, menaxhim dhe financim nga struktura të pavarura nga qeverisja qendrore. Transferimi kryesisht bën kalimin e përgjegjësive në organet e qeverisjes vendore.

III. Avantazhet dhe Disavantazhet e Decentralizimit

Decentralizimi, ka një varg avantazhesh:

- Sjell shërbimet me afër komunitetit.
- Rrit pjesëmarrjen e komunitetit në qeverisje.
- Rrit efektivitetin në përdorimin e burimeve vendore.
- Zhvillon ndërgjegjësimin e nëpunësve të qeverisjes qendrore drejt kushteve dhe nevojave të veçanta vendore.
- Lejon një përkushtim më të thellë të nëpunësve të qeverisjes vendore drejt çështjeve strategjike dhe politike.
- Rrit përgjegjësinë e iniciativave të qeverisë drejt nevojave vendore.
- Thjeshtëzon procedurat burokratike në planifikimin qendror qeverisës dhe kontrollin e programeve sociale

Por decentralizimi ka gjithashtu edhe disavantazhet e tij:

- Cilësia e shërbimeve mund të përkeqësohet, pasi ndonjëherë agjensitë vendore kanë mungesa të kapaciteteve të duhura për të përballuar detyrat e transferuara.
- Rritet mundësia e një polarizimi të zhvillimit për shkak të diferencave social-ekonomike, etnike dhe politike.
- Politika qendrore mund të sfidohet nga grupe të caktuara që kanë influenca në nivel vendor.

Ky proces duhet të realizohet nëpërmjet një balancimi të kujdesshëm ndërmjet centralizimit dhe decentralizimit në format e tij të ndryshme, shoqëruar me ndërgjegjësimin e plotë për risqet dhe mundësitë e suksesit.

Mundësitë drejt suksesit mund të rriten si rrjedhojë e një implementimi praktik dhe progresiv, me një metodë eksperimentimi, ku i gjithë procesi i ndryshimit të ndahet në faza. Hapja e të dy niveleve, qendror dhe vendor, drejt një procesi të vazhdueshëm bashkëpunimi dhe kualifikimi, si dhe kultura e tradita vendore janë elementë thelbësorë për një proces të suksesshëm decentralizimi.

IV. Përvoja ndërkombëtare

Decentralizimi i sistemit arsimor kërkon një harmonizim të një grupi kompleks funksionesh. Një numër vendesh të Evropës Lindore kanë ndërmarrë reforma decentralizimi me nivele të ndryshme suksesi.

Nga eksperiencia e shumë vendeve është provuar se funksionet që kryhen më mirë në nivelin e qeverisjes qendrore janë si më poshtë:

- a. Zhvillimi i strategjive kombëtare
- b. Përcaktimi i standarteve akademike dhe administrative
- c. Hartimi i akteve ligjore dhe nën ligjore
- d. Përcaktimi i kurrikulave
- e. Kualifikimi i mësuesve
- f. Vlerësimi dhe testimi në nivel kombëtar
- g. Prodhimi dhe shpërndarja i teksteve shkollore
- h. Planifikimi financiar
- i. Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar
- j. Licensimi i shkollave dhe Institucioneve të Kualifikimit të mësuesve
- k. Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Sistemit Informatik Arsimor
- l. Mbikqyrja ligjore dhe inspektimi akademik

Në disa raste (SHBA) qeveria federale u ka deleguar shteteve krijimin e standardeve akademike.

Në disa shtete si (Nigeria, Nikaragua) pushtetit vendor i është dhënë liria për të përcaktuar hartimin e kurrikulave sipas nevojave të tyre specifike. Megjithatë Punësimi dhe Kariera e Mësuesit janë funksion i nivelit qeverisës qendror, në shumicën e vendeve në zhvillim, disa vende të mëdha me një strukturë federale, si Brazili dhe India, kanë zhvilluar një strukturë punësimi që i jep autoritet niveleve vendore.

Financimi është kryesisht një funksion i shpërndarë në nivelin qendror. Në shumicën e vendeve nivelet vendore qeverisëse kanë përgjegjësinë për disa shërbime arsimore, ndërkohë që niveli qendror alokon fondet e kërkuara sipas kriterëve të paracaktuara. Në shumicën e rasteve, komunitetet kanë adaptuar një përgjegjësi të pjesshme në sigurimin e fondeve, që vijnë nga taksat vendore, sektori privat, prindërit dhe pagesat e mundshme për shkollim.

Përgjegjësia për pagat zakonisht bie mbi nivelin qendror, ndërsa pagesa fizike bëhet si rregull nga një agjenci vendore-d.m.th nga shkolla apo përfaqësuesi i qeverisë vendore, pasi është realizuar transferimi i fondeve nga qeverisja

qendrore. Në shumicën e rasteve, komunitetet përpiqen të gjejnë një mënyrë për të paguar disa nga rrogat e mësuesve të tyre, për të rritur ndjeshmërinë ndaj nevojave vendore, për të përmirësuar raportin mësues/nxënës, dhe për të shpërblyer mësuesit për projekte të veçanta.

Përgjegjësia për ndërtimin dhe mirëmbajtjen zakonisht ndahet ndërmjet nivelit qendror dhe vendor. Në disa vende (siç ndodh edhe në vendin tonë) niveli vendor krijon lehtësirat, ndersa kompetencat për ndërtimin dhe reabilitimin i ka qeverisja qendrore. Ndarja midis pronësisë së objekteve dhe përgjegjësisë dhe kompetencave për t'i ndërtuar, rehabilituar dhe mirëmbajtur, mbështetet në akte ligjore dhe nënligjore.

V. Gjendja aktuale në fushën e decentralizimit të arsimit parauniversitar në vendin tonë

Decentralizimi i shërbimeve është një nga fushat ku qeveria shqiptare po demonstroi angazhim serioz dhe në një sërë sektorësh ka avancime të dukshme, pasi është siguruar konsensusi midis tërë palëve të interesuara.

Qeverisja qendrore ka bërë përpjekje drejt transferimit të shumë prej përgjegjësive dhe kompetencave të saj, si:

- Shkollat lejohen të krijojnë të ardhura përmes sigurimit të shërbimeve të tilla si, dhënia me qera e mjediseve të objekteve shkollore, kontributi i prindërve dhe komunitetit.
- Mirëmbajtja e shkollës dhe riparimet bëhen nga pushteti vendor.
- Ka zhvillime në arsimin jopublik.
- Qendra Kombëtare e Arsimit për Vlerësim dhe Provimeve luan një rol unik në vlerësimin e niveleve të ndryshme të sistemit arsimor
- Jane në proces formimi Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin (QTKA) dhe Instituti i Kurrikulave dhe Standardeve (IKS).
- Botimi, shtypja dhe shpërndarja e teksteve shkollore është liberalizuar tërësisht.
- Skema e menaxhimit të arsimit, megjithëse vazhdon të mbetet funksion qendror, ka adaptuar elementë të rëndësishëm dekoncentruar, nëpërmjet krijimit të 13 Drejtorive Arsimore Rajonale dhe 24 Zyrave Arsimore, duke mundësuar delegimin e një sërë përgjegjësish dhe kompetencash në nivelin vendor. Këto veprime janë një demonstrim konkret i vullnetit të qeverisë për të decentralizuar menaxhimin e Sektorit të Arsimit në

Shqipëri, duke krijuar kështu parakushtet për një transferim të plotë të shumë përgjegjesive dhe kompetencave në nivelin e strukturave vendore.

VI. Objektivat kryesorë të zhvillimit drejt një sistemi arsimor të decentralizuar

Zhvillimet e mëtejshme, të domosdoshme për të rritur shkallën e decentralizimit të Sistemit Arsimor në Shqipëri, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë objekt i diskutimeve dhe konsultimeve midis tërë palëve të interesuara, duke patur parasysh komponentet e mëposhtme:

- Nevojën për të përcaktuar qartë rolet për një autonomi më të gjërë në nivel qarku, bashkie, komune dhe shkolle, e koordinuar me pjesëmarrjen e tërë palëve të interesuara, për një realizim efikas të objektivave arsimore
- Shpërndarjen e përgjegjësive, shoqëruar me transferimin e kompetencës në nivel vendor, duke përcaktuar edhe modalitetet e përgjegjshmërisë.
- Forcimin e Kapaciteteve në të gjitha nivelet e Sektorit të Arsimit.
- Riorganizimin e skemës financiare përmes decentralizimit gradual.
- Krijimin e një sistemi treguesish, që të lejojë matjen dhe vlerësimin e performancës.

Në arsimin parauniversitar, dokumenti i zhvillimit strategjik të sektorit (strategjia), që është në fazën përfundimtare, ka parashikuar ndërhyrje të rëndësishme reformuese edhe në fushën e decentralizimit të sistemit.

Të gjitha zhvillimet e pritëshme të sistemit arsimor, përfshirë dhe decentralizimin e tij, i referohen objektivit themelor:

Sigurimi i shërbimeve arsimore, nga agjenci qendrore apo vendore, duhet të fokusohet në procesin e mësimdhënies dhe të të mësuarit, për të siguruar arritjet më të larta akademike dhe zhvillimin maksimal të individit.

Filozofia e re e orientimit drejt rezultatit kërkon:

- Standarde për performancën për të gjitha agjencitë dhe personelin e përfshirë në procesin mësimor
- Adaptimin e një “kulture” të re për matjen dhe vlerësimin e Sistemit arsimor.

- Menaxhimi i bazuar në performancë. Personeli do të vlerësohet nga eprorët në bazë të performancës personale. Për çdo post do të përcaktohet një grup standardesh, duke filluar nga mësuesit, drejtorët, personeli lokal e rajonal deri te funksionarët qendrore.
- Përgjegjësia, kompetenca dhe përgjegjshmëria. Shpërndarja e re e përgjegjësive, e realizuar nga një skemë e qartë, do të shoqërohet nga kompetenca përkatëse për të kryer detyrën dhe për të marrë vendime. Çdo përgjegjësi shoqërohet me kompetencën përkatëse, duke përcaktuar edhe linjën e përgjegjshmërisë.
- Skema e financimit. Çdo shpërndarje e re përgjegjësish do të shoqërohet me skemën korresponduese të financimit, të koordinuar me të tërë operatorët dhe të tjerë aktorë të interesuar.
- Stuktura ligjore. Çdo alokim i ri përgjegjësish do t'i referohet strukturës ligjore ekzistuese dhe, kur është e nevojshme, do të bëhen ndryshimet përkatëse ligjore.
- Standartet akademike. Sistemi do të përcaktojë standartet akademike për arritjet e nxënësve, për të lejuar matjen e rezultateve dhe vlerësimin e performancës së drejtuesve, mësuesve dhe shkollës.
- Sistemi i informacionit. Sistemi i arsimit do të zhvillojë një sistem informimi për publikun, duke bërë të njohura arritjet, nivelin e performancës së shkollave, planet e zhvillimit, etj
- Standardet administrative. Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të zhvillojë, në bashkëpunim me agjensitë që kanë lidhje (Ministrinë e Financave, Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Bashkitë dhe Komunat), një set standardesh për infrastrukturën fizike të objekteve shkollore, pajisjet dhe rinovimin e tyre, mirëmbajtjen e shkollave, raportin mësues/nxënës, numrin i nxënësve për klasë, etj.
- Postet kyçe. Drejtori i shkollës dhe mësuesit janë postet kyçe për finalizimin e decentralizimit të sistemit. Drejtorët do të kenë përgjegjësinë dhe kompetencën për menaxhimin dhe vlerësimin e personelit mësimdhëns dhe administrativ sipas standardeve kombëtare, duke përfshirë edhe kompetencat për të rekrutuar, graduar, shpërblyer apo pushuar nga puna.
- Pjesëmarrja në zhvillimin e kurrikulave. Zhvillimi i kurrikulave do të mbetet një funksion qendror. Megjithatë, mësuesit do të inkurajohen për të sugjeruar përmirësime dhe zhvillime të

mëtejshme të materialeve didaktike sipas eksperiencës së tyre konkrete. Agjencia qendrore e ngarkuar me Zhvillimn e Kurrikulave do të zhvillojë 100% të përmbajtjes për çdo klasë dhe lëndë. Në disa zona vetëm 85% i këtij programi akademik do të jetë i detyrueshëm. Pjesa që mbetet (15%) do të zhvillohet nga vetë shkolla në konsultim me komunitetin. Përtëritja e vazhdueshme e kurrikulave do të marrë parasysh përfshirjen e sugjerimeve në botimet e reja.

- Kualifikimi i mësuesve. Përgatitja e mësuesve do të mbetet përgjegjësi në nivel qendror, por realizimi konkret mund të bëhet edhe nga agjenci të pavarura. Për nevojat specifike të rajoneve të ndryshme mund të ketë përjasje specifike.
- Këshillat drejtues (bordi). Këshillat drejtuese do të funksionojnë në të gjitha shkollat, si shprehje e vullnetit të komunitetit. Drejtorët do të raportojnë tek Kryetari i Bordit të shkollës si edhe te përfaqësuesit e zgjedhur vendorë. Kryetari i Bordit do të ketë kompetencën për të rekrutuar sipas procedurave të standardizuara në nivel kombëtar dhe pushuar nga puna drejtorin, për të rishikuar planin e shkollës dhe buxhetin.
- Forcimi i Kapaciteteve. Decentralizimi do të shoqërohet me angazhime dhe veprime të programuara për forcimin e kapaciteteve. Mësuesit, Drejtorët, Inspektorët, pushtetarët vendorë e qendrorë, që merren me arsimin si edhe antarët e bordit, do të përfshihen në një proces kualifikimi të përcaktuar, për të patur kapacitetet e nevojshme menaxhuese në Sektorin e Arsimit të decentralizuar në Shqipëri.

VII. Ndarja e përgjegjësive dhe kompetencave midis pushtetit qendror dhe pushtetit vendor në Sektorin Arsimor të decentralizuar

Duke patur parasysh drejtimit kryesorë të procesit të decentralizimit të treguar më sipër, në mënyrë specifike evidentohet edhe pushteti vendor, si një faktor shumë i rëndësishëm në skemën aktuale dhe të ardhëshme. Një pjesë e konsiderueshme e zhvillimeve drejt decentralizimit nuk e përfshijnë në mënyrë direkte pushtetin vendor. Për shkak të implikimeve ligjore ndarja e përgjegjësive midis pushtetit qendror dhe atij vendor përbën një domosdoshmëri. Për këtë arsye, në këtë dokument ky problem trajtohet në mënyrë specifike. Lidhur me drejtimit e tjera të zhvillimit që do të realizojnë gradualisht një sistem arsimor të decentralizuar, do të duhen reformime thelbësore të skemës aktuale të menaxhimit, por që do të mund të bëhen brenda vetë sistemit.

Duke e kuptuar rëndësinë e ndarjes së përgjegjësive midis dy pushteteve, më poshtë përshkruhet një skemë e mundëshme për këtë ndarje.

Me “Pushtet Qendror” nënkuptohen Qeveria, Institucionet Qendrore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe strukturat e saj administrative në nivel vendor.

Me “Pushtet Vendor” nënkuptohen organet e qeverisjes vendore në Bashki, komunë dhe Qark, si dhe institucionet administrative respektive.

“Shkolla” është struktura bazë, e cila ka përgjegjësi dhe kompetenca të transferuara nga Pushteti Qendror dhe Vendor, duke shërbyer kështu si hallka kryesore e “kontaktit” të të dy Pushteteve.

Shpërndarja e përgjegjësive brenda pushtetit vendor bëhet në përputhje me rolin që luajnë organet përkatëse vendore në bashki, komunë dhe qark sipas ligjit.

Skema do të jetë si më poshtë:

1. Personeli mësimor (Drejtorët, mësuesit,)

1.1 Karriera

- | | |
|-------------------------|----------|
| ▪ Politika dhe kriteret | Qendrore |
| ▪ Rekrutimi dhe largimi | Shkollë |
| ▪ Gradimi | Qendrore |
| ▪ Transferimi | Qendrore |
| ▪ Financimi | Qendrore |

Pushteti vendor mund të mbështesë me mjetet e veta financiare personelin mësimor. Njëkohësisht pushteti vendor bën shërbimin e pagesës së personelit mësimor nga fondi i kushtëzuar i caktuar nga Pushteti qendror për këtë qëllim.

Procesi i rekrutimit do të jetë mbi bazë konkurimi. Pushteti vendor mund të ofrojë stimuj për kushtet e punës.

1.2 Kualifikimi

- | | |
|--|--------------------------|
| • Pergatitja fillestare (para shërbimit) | Qendrore |
| • Planifikimi i kualifikimit ne shërbim | Qendrore e dekoncentruar |
| • Kualifikimi ne shërbim | Qendrore e dekoncentruar |
| • Financimi | Qendrore |

1.3 Normat e ngarkesës mësimore dhe detyrat

- | | |
|---|--------------------------|
| • Standardet kombëtare | Qendrore |
| • Pëcaktimi i numrit të stafit që nevojitet për institucion/për vit /për funksion | Qendror/ e Dekoncentruar |
| • Përshkrimet e punës | Qendror/ e Dekoncentruar |

- Struktura kohore e punësimit (me orar të Qendror/ e Dekoncentruar pjesëshëm dhe të plotë)

1.4 Vlerësimi

- Përcaktimi i standardeve të performancës Qendror
- Përcaktimi i kodit të sjelljes morale Qendror
- Mbikqyrja Vendor/Qendror
- Vlerësimi i performancës Qendror dhe Vendor

Pjesëmarrja e pushtetit vendor në vlerësimin e performancës nënkupton vlerësimin që i bëhet veprimtarisë së shkollës nga komuniteti dhe përfaqësuesit e zgjedhur.

2. Personeli jomësimor (punonjës shërbimi përfshirë të gjithë personelin e konvikteve)

- Standardet Qendrore
- Rekrutimi dhe largimi Vendor
- Financimi (përveç rastit të konvikteve për arsimin e detyruar) Vendor
- Financimi për pjesën e arsimit të detyruar Qendror/dekoncentruar

3. Programe lëndore dhe kurrikula

- Përcaktimi i programeve lëndore Qendror/Shkollë/Vendor
- Zhvillimi i kurrikulave Qendror
- Përcaktimi i lidhjeve horizontale dhe vertikale për të tërë lëndët/klasat/ moshat. Qendror/Shkollë/Vendor
- Mjetet matëse të arritjeve në zhvillim Qendror/Shkollë/Vendor
- Kualifikimi i mësuesve mbi kurrikulat dhe standartet e reja Qendror
- Financimi Qendror

Në përputhje me strategjinë e zhvillimit të arsimit parauniversitar, një pjesë e kurrikulës do të jetë e lirë për t'ju përshtatur nevojave vendore për edukim specifik. Pushteti vendor, komuniteti dhe aktorë të tjerë lokalë të interesuar do të përcaktojnë përmbajtjen e kësaj pjese të kurrikulës në bashkëpunim me shkollat.

4. Testimi

- Përcaktimi i standardeve Qendror
- Matja e vlerësimit të nxënësve Qendror

- Matja e vlerësimit te institucionit Vendor/Qendror
- 5. Sistemi i informatizimit në arsim**
- Mbledhja e të dhënave Vendor/Qendror
 - Analiza e të dhënave Qendror
 - Raportet Qendror/Vendor
- 6. Tekstet shkollore**
- Planifikimi dhe përzgjedhja e autorëve dhe botuesve Qendror
 - Hartimi dhe botimi Qendror
 - Prodhimi dhe shpërndarja Qendror/dekoncentruar
 - Reflektimi i përfituesve Vendor/Qendror
 - Vlerësimi Qendror/Vendor
 - Financimi Qendror
 - Subvencionimi Qendror/Vendor

Pushteti vendor përfshihet vetëm në zërin subvencion.

7. Pajisjet dhe materialet

- Përcaktimi i nevojave Shkolla
- Standardet dhe procedurat Qendror
- Sigurimi i pajisjeve dhe materialeve (përveç laboratorëve kurrikularë që sigurohen nga Niveli qendror) Vendor
- Mirëmbajtja dhe riparimet Vendor
- Financimi Qendror/vendor

Pushteti vendor mund të financojë nga buxheti i tij.

8. Infrastruktura e shkollës

- Përcaktimi i standardeve Qendror
- Realizimi i punimeve civile Vendor
- Inspektimi i punës Vendor/Qendror
- Financimi Qendror

MASH do të përcaktojë parimet, rregulloret dhe standardet.

Nevojat do të identifikohen nga organet e qeverisjes vendore (komunë dhe bashki), do të përpunohen në nivel qarku, përfshirë në mënyrë specifike bashkite qender qarku, dhe do të dërgohen në MASH. MASH, në kuadër të politikave dhe standardeve kombëtare, do t'i paraqesë Ministrisë së Financave programin përkatës të investimeve për çdo bashki qender qarku dhe për bashkite dhe komunat tjera, keshillave të qarqeve perkatese. MF e përfshin këtë program në ligjin për buxhetin vjetor për qarqet dhe bashkite qender qarku, duke filluar nga viti fiskal 2005.

Organet e qeverisjes vendore në nivel qarku dhe bashkite qender qarku janë përgjegjëse për përdorimin e këtij buxheti.

Njesite e qeverisjes vendore mund të financojnë nga të ardhurat e veta për ndertimin dhe rikonstruksionin e kopeshteve dhe shkollave të arsimit parauniversitar.

Bashkite dhe Komunitat përgjigjen për realizimin e investimeve të reja ndertimore dhe riparimet kapitale me fonde nga buxheti i shtetit, fondet e veta apo nga donatorët, mbi bazën e planit vjetor dhe duke respektuar standartet e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Mirëmbajtja

- | | |
|----------------------------|---------|
| • Përcaktimi i standardeve | Qendror |
| • Realizimi i shërbimit | Vendor |
| • Mbikqyrja | Vendor |
| • Rinovimi i pajisjeve | Vendor |
| • Financimi | Vendor |

Financimi për pajisjet që rinovohen është pjesë e fondit të investimeve.

10. Planifikimi

- | | |
|---------------------|----------------|
| • Ndarja në zona | Qendror/Vendor |
| • Licensimi | Qendror |
| • Hapja dhe Mbyllja | |
| Shkollat Publike | Qendror/vendor |
| Shkollat Jo-publike | Vendor/Qendror |

Për hapjen e shkollave publike vendimin e merr pushteti qendror mbi bazën e propozimit ose konsultimit me pushtetin vendor.

11. Transporti i nxënësve dhe mësuesve

- | | |
|---------------------------|-------------------------|
| • Planifikimi | Qendror i dekoncentruar |
| • Financimi dhe realizimi | Qendror i dekoncentruar |

12. Regjistrimi i nxënësve

- Percaktimi i kriterëve për regjistrimin Qendror
- Planifikimi dhe shpërndarja Vendor/qendror i dekoncentruar

13. Bursat

- Përcaktimi i Standardeve Qendrore/ MPÇS
- Planifikimi në Nivel Kombëtar Qendror MPÇS
- Financimi Qendror
- Identifikimi dhe alokimi tek studentët dhe nxënësit Vendor

Mekanizmi i financimit:

Organet vendore do t'i adresojnë nevojat e tyre për bursa tek Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale. MPÇS do të përfaqësojë organet vendore në Qeveri për këtë problem. Me miratimin e buxhetit, MPÇS do të realizojë shpërndarjen e fondeve për bursat e dhëna në rajonet dhe nën-nivelet e tyre. Organet vendore dhe nën-nivelet e tyre do të alokojnë bursat tek studentët dhe nxënësit.

VIII. Fazat e decentralizimit të Sistemit të Arsimit parauniversitar

Duke u konsideruar decentralizimin si një proces kompleks, të vazhdueshëm dhe të kushtëzuar, transferimi i përgjegjësive dhe kompetencave duhet të mbështetet në filozofinë e kalimit progresiv, kryesisht nëpërmjet pilotimit.

Kushtëzimet kryesore janë:

- A. Alokimi i qartë i përgjegjësisë dhe autoritetit si dhe percaktimi i skemës së varësisë.
- B. Përcaktimi i kriterëve të financimit, alokimit të fondeve dhe i procedurave.
- C. Kuadri ligjor i kërkuar.
- D. Ngritja e Kapaciteteve.
- E. Vlerësimi

Transferimi i një kategorie përgjegjësish, nuk mund të bëhet në mënyrë të menjëherëshme në shkallë vendi, prandaj duhet të kalohet nëpër faza të ndërmjetme pilotimi.

Rasti i pilotimit të transferimit të përgjegjësive së investimeve në Bashkinë e Tiranës është një shembull konkret i kësaj filozofie. Vlerësimi pozitiv i pilotimit te

decentralizimit të investimeve në bashkinë e Tiranës krijon mundësinë e shtrirjes së decentralizimit të investimeve në shkallë vendi.

Duke ju referuar skemës së ndarjes së përgjegjësisë të treguar më sipër, evidentohen tre kategori problemesh:

- Zhvillime brenda vetë sistemit aktual për të realizuar objektivat në fushën e decentralizimit, të lidhura sidomos me rolin e shkollës
- Përgjegjësi të parashikuara për të kaluar në pushtetin vendor,
- Përgjegjësi që mund të transferohen menjëherë.

a- Zhvillimet brenda sistemit

Institucionet qendrore, kryesisht Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të formulojnë një plan konkret veprimi për implementimin e elementëve decentralizues të parashikuar në këtë dokument brenda një periudhe katër vjeçare. Për këtë MASH do të bashkëpunojë me tërë aktorët e interesuar, duke rritur ndjeshëm rolin e shkollës dhe të agjencive të pavarura ose pothuajse të pavarura.

Për problemin e bursave MASH duhet të bashkëpunojë me MPCPS për ta transferuar përgjegjësinë brenda vitit 2004 tek MPCPS.

b- Përgjegjësi që mund të transferohen menjëherë.

Të tilla janë:

- Mirëmbajtja dhe planifikimi i shkollave
- Transporti i nxënësve dhe mësuesve
- Ndertimi dhe rehabilitimi i institucioneve shkollore (përfshirë edhe paisjet)

c- Përgjegjësi të parashikuara për të kaluar në pushtetin vendor, pas një faze pilotimi

Të tilla janë:

- Personeli jomësitor (punonjës shërbimi përfshirë të gjithë personelin e konvikteve)
- Menaxhimi i sistemit të konvikteve, përjashtuar nxënësit e arsimit të detyruar

Lidhur me personelin jomësitor të pilotohet në dy qarqe në periudhën 2004-2005

Lidhur me përgjegjësinë e menaxhimit të konvikteve të pilotohet në dy qarqe për periudhën 2004-2005

IX. Të përgjithshme

Pilotimi

Në çdo rast periudha e pilotimit do të shërbejë si periudhë tranzitore. **Ndarja e përgjegjësisë dhe afatet e transferimit të pikes c do të varen nga rezultati i pilotimit.**

Financimi

Skema e financimit do të mbështesë të gjitha transferimet e përgjegjësisë, si ato të menjëherëshme, ashtu edhe ato të pilotuara, duke u reflektuar në ligjin e buxhetit të shtetit të çdo viti.

Ndërhyrjet ligjore

Brenda vitit 2004 të amendohet ligji për arsimin parauniversitar në përputhje me këtë dokument, sidomos për përgjegjësitë që transferohen menjëherë dhe duke hapur hapësirën për pilotimet e sugjeruara.

Pushteti qendror të angazhohet për ngritjen e kapaciteteve të nivelit vendor, sidomos në njësitet ku do të pilotohet.

**MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR
DHE DECENTRALIZIMIT**

Ben BLUSHI

**MINISTRI I ARSIMIT
DHE SHKENCES**

Luan MEMUSHI

Tirane, më ____ .05.2004